



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 215/2013

6 mars 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJL
nr. 3, datë 6.12.2013

Me objekt: - Kundërshtimi i pensionit të parakohshëm.
- Detyrimi i palës së paditur të bëjë rillogaritjen sipas ligjit në fuqi në kohën e fitimit të pensionit nga data 1.8.2005.
- Detyrimin e palës së paditur të më kthejë diferencat e papaguara nga data 1.8.2005..... 9359

Urdhër i BSH
nr. 2027, datë 4.10.2013

Për miratimin e licencës për subjektin “Paylink” sh.a. si operator skeme kombëtare të pagesave me kartë..... 9375

Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Armand Koxhaj..... 9375

VENDIM
Nr. 3, datë 6.12.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Xhezair Zaganjori	kryesues
Ardian Dvorani	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Aleksandër Muskaj	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Majlinda Andrea	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Medi Bici	anëtar
Edmond Islamaj	anëtar
Shkëlzen Selimi	anëtar
Artan Zeneli	anëtar
Admir Thanza	anëtar
Artan Broci	anëtar

Në seancën gjyqësore të datës 6.12.2013, morën në shqyrtim çështjen administrative nr. 3 akti, që u përket palëve:

PADITËS: Enver Ajdari, përfaqësuar nga avokat Gentian Muça.

I PADITUR: Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, përfaqësuar nga juriste Egesta Bare.

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit, përfaqësuar nga Abaz Deda dhe Armer Juka.

OBJEKTI: - Kundërshtimi i pensionit të parakohshëm.

- Detyrimi i palës së paditur të bëjë rillogaritjen sipas ligjit në fuqi në kohën e fitimit të pensionit nga data 1.8.2005. - Detyrimin e palës së paditur të më kthejë diferencat e papaguara nga data 1.8.2005.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 1, pika 2 e ligjit nr. 9418, datë 16.2.2005.

Neni 11, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996.

Neni 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 8521, datë 30.7.1999.

Neni 32 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5550, datë 16.6.2008, ka vendosur:

Pranimin e padisë.

Detyrimin e palës së paditur, DRSSH Tiranë, që t’i paguajë paditësit Enver Ajdari, diferencën e pensionit të papaguar që nga data 1.8.2005, si pasojë e moszbatimit të drejtë të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të

Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), duke mbajtur parasysh në pagesën e kësaj difference, se neni 11 i ligjit të mësipërm është ndryshuar me nenin 49 të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ku është shfuqizuar shprehja “por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi”.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 678, datë 14.5.2009, ka vendosur:

Lëniën në fuqi të vendimit nr. 5550, datë 16.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, në bazë të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Nuk jemi dakord me këto vendime, pasi nuk është gjykuar drejt për sa i përket ligjit mbi bazën e të cilit duhet të bëhet dhe llogaritja e diferencave të pensionit.

- Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, sepse në vendimin e saj, kjo gjykatë është shprehur se llogaritja e diferencave që nga data 1.8.2005, duhet të bëhet në bazë të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Ky nuk është ligji material i zbatueshëm për ushtarakët që dalin në pension të parakohshëm, sepse ky ligj në nenin 35 të tij, pika 3 parashikon se kriteret dhe kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm përcaktohen sipas ligjit “Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”.

- Në datën 1.1.2006 ka hyrë në fuqi ligji nr. 9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i cili, në nenin 14 të tij, parashikon një masë pensioni të kufizuar deri në katërfishin e pensionit bazë në shkallë vendi. Pra, nga data 1.1.2006 nuk mund të llogaritet diferenca duke iu referuar nenit 49 të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” pa kufizim, siç arsyetojnë gjykatat.

- Po kështu, ligji nr. 9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, është ndryshuar me ligjin nr. 9481, datë 16.2.2006. Me anë të nenit 2 të këtij ligji amendues është ndryshuar edhe neni 14 i ligjit nr. 9418, datë 20.5.2005, duke e kufizuar masën e pensionit të parakohshëm në referim të gradës përkatëse të ushtarakut.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pas caktimit të datës për gjykimin e kësaj çështjeje pa

praninë e palëve, nisur nga fakti se shkaku dhe objekti i padisë lidhet me një mosmarrëveshje administrative, çmoi se paraprakisht duhet të shtrohet për bisedim çështja se cili është ligji procedural i zbatueshëm në rastin konkret.

Çështja objekt gjykimi lidhet me zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje administrative, e cila ka filluar të shqyrtohet para datës 4.11.2012, datë në të cilën pas dekretit të Presidentit të Republikës, të nxjerrë në zbatim të nenit 70/5 të ligjit nr. 49/2012, kanë filluar realisht që të ushtrojnë funksionin e tyre gjykatat administrative.

Ligji nr. 49/2012 nuk përmban ndonjë dispozitë kalimtare ku të jetë shprehur në lidhje me ligjin e zbatueshëm për mosmarrëveshjet administrative, që ishin në gjykim, apo gjykimi i të cilave nuk kishte filluar akoma deri në datën 4.11.2013.

Në këto kushte, Kolegji Administrativ mban parasysh parimin se për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të natyrës civile dhe administrative, ndryshe nga ato penale, gjykata nuk mund të refuzojë shqyrtimin e çështjes me arsyetimin se ligji mungon.

Për këto arsye, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e pa të nevojshme diskutimin në Kolegje të Bashkuara lidhur me çështjen nëse kompetenca për shqyrtimin e këtij rekursi i përket Kolegjit Administrativ apo Kolegjit Civil, me qëllim dhënien e një interpretimi përfundimtar lidhur me zbatimin e këtij ligji.

Kolegji Administrativ, në gjykimin e çështjes konkrete, vlerësoi se interpretimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara i shërben zgjidhjes së problemeve që janë krijuar në praktikë në gjykatat e të gjitha niveleve, si dhe zbatimit të ligjit në mënyrë të drejtë e në përputhje me vullnetin e ligjvënësit në gjykimin e çështjeve, për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar para datës 4.11.2013, apo shqyrtimi i të cilave ka filluar para kësaj date dhe ende nuk është dhënë vendim përfundimtar për to.

Për këto arsye, Kolegji Administrativ vlerësoi se duhet të paraqesë për shqyrtim dhe interpretim të njëzuar të ligjit nr. 49/2012 çështjet e mëposhtme:

1. Në kushtet kur ligji nr. 49/2012 nuk përmban dispozitë kalimtare ku të përcaktohet se cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 4.11.2013 në gjykatën e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatën e Lartë, ose për mosmarrëveshjet administrative që ishin në shqyrtim para këtyre gjykatave në datën 4.11.2013, a duhet të shqyrtohen ose të vijojë gjykimi i këtyre çështjeve nga gjykatat ku ato janë paraqitur para kësaj date apo duhet t'i kalojnë për kompetencë lëndore gjykatës administrative të shkallës së parë, gjykatës së apelit

administrativ dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë?

2. A gjejnë zbatim parashikimet e neneve 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, që kufizojnë rastet e pranueshmërisë për shqyrtim të ankimeve dhe të rekurseve për mosmarrëveshjet administrative, edhe për ankimet drejtuar gjykatës së apelit dhe rekurset drejtuar Gjykatës së Lartë përpara datës 4.11.2013, duke qenë se nuk ka rregullim të shprehur me dispozitë kalimtare për këtë qëllim?

3. Mbi bazën e cilave kritere dhe në çfarë mënyre përcaktohet vlera prej njëzetfish ose dyzetfish e pagës minimale në shkallë vendi, veçanërisht në rastin e shkronjës "ç" të neneve 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, në kushtet kur ato nuk janë të rregulluara nga ligji i posaçëm?

4. Nisur nga qëllimi dhe vullneti i ligjvënësit në miratimin e ligjit nr. 49/2012, si dhe nga kufijtë e kompetencës lëndore të gjykatës për mosmarrëveshjet administrative, të parashikuara nga neni 7 i ligjit nr. 49/2012, krahasuar këto me kufizimin e llojeve të mosmarrëveshjeve administrative, të parashikuara nga nenet 45 dhe 56 të këtij ligji, cili është interpretimi në funksion të zbatimit të drejtë që duhet t'u bëhet këtyre dispozitave?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Ardian Dvorani dhe Guxim Zenelaj; përfaqësuesin e palës rekursuese, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, që kërkoi ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë; përfaqësuesin e Avokaturës së Shtetit, që kërkoi ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë; përfaqësuesin e paditësit, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, si dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Enver Ajdari ka qenë ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me gradën nënkolonel dhe me vjetërsi shërbimi prej 30 vjet e 3 muaj. Nga dosja gjyqësore, rezulton që shuma e pagës referuese për efekt të përfitimeve nga sigurimet shoqërore suplementare është në shumën 62.600 lekë. Paditësi Enver Ajdari, mbi bazën e kërkesës së tij për përfitimin e pensionit, i është lidhur pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi nga ana e palës së paditur në vlerën 15.693 lekë, të cilën e përfiton nga data 1.8.2005 deri në datën kur paditësi të arrijë moshën për përfitimin e pensionit të pleqërisë.

2. Pasi ka marrë përgjigje negative nga organet kompetente, që kanë shqyrtuar ankimin e tij, lidhur me pretendimin se kjo masë pensioni i është lidhur duke zbatuar gabim ligjin, paditësi Enver Ajdari i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi, ku kundërshton masën e pensionit të parakohshëm që i është caktuar nga pala e paditur, duke e detyruar atë të bëjë rilogaritjen sipas ligjit në fuqi në kohën e përfitimit të pensionit, si dhe t'i kthejë diferencat e papaguara nga data 1.8.2005.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, që t'i paguajë paditësit Enver Ajdari diferencën e pensionit të papaguar që nga data 1.8.2005, si pasojë e moszbatimit të drejtë të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), duke mbajtur parasysh në pagesën e kësaj difference se neni 11 i ligjit të mësipërm është ndryshuar me nenin 49 të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", ku është shfuqizuar shprehja "por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi".

Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë thekson se neni 11 i ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) dhe neni 35 i ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", përbëjnë bazën ligjore që ka qenë në fuqi në kohën që paditësit Enver Ajdari i ka lindur e drejta që të përfitojë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Paditësi nuk mund të penalizohet nga pala e paditur, pasi në çastin që atij i ka lindur e drejta për përfitimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, baza juridike mbi të cilën do të jepej ky pension i parakohshëm nuk parashikonte ndonjë kufizim në tavanin që mund të arrinte pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 678, datë 14.5.2009, me të njëjtin arsyetim, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5550, datë 16.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë, për shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë:

5. Lidhur me çështjen e parë, që është shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë:

Ligji nr. 49/2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 53 të vitit 2012 dhe ka hyrë në fuqi në datën 30 maj 2012, pra 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, siç parashikohej në nenin 73 të tij.

Pavarësisht se ligji nr. 49/2012 ka hyrë në fuqi në datën 30.5.2012, ai ka filluar të zbatohet vetëm pjesërisht për shkak të kohës së domosdoshme që nevojitej për ngritjen dhe funksionimin efektiv të gjykatave administrative, sipas parashikimeve të shprehura posaçërisht në të.

6. Ligji nr. 49/2012, në kreun X të tij "Dispozita kalimtare dhe të fundit", në pikën 1 dhe 5 të nenit 70 "Fillimi i funksionimit të gjykatave administrative", parashikon se:

"1. Gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë fillojnë funksionimin e tyre në mënyrë të njëkohshme".

5. Data e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative caktohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë".

Në zbatim të nenit 70/5 të ligjit nr. 49/2012, bazuar në propozimin e ministrit të Drejtësisë, Presidenti i Republikës ka nxjerrë dekretin nr. 8349, datë 14.10.2013, në të cilin ka përcaktuar datën 4.11.2013 si ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative. Kjo datë shënoi dhe fillimin e efekteve të plota juridike dhe zbatimin në tërësi të ligjit nr. 49/2012 lidhur me juridiksionin, kompetencën dhe procedurën e gjykimit të çështjeve që kanë për objekt mosmarrëveshjet administrative të përmendura në nenin 7 të tij.

7. Neni 72, pika 1 dhe 2 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se me fillimin e funksionimit të gjykatave administrative, të përcaktuar me dekretin e Presidentit të Republikës, shfuqizohen normat procedurale mbi kompetencën lëndore dhe tokësore, si dhe normat ekzistuese procedurale të posaçme mbi gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile.

8. Në këto kushte, për shkak të mënyrës së formulimit të nenit 72 të ligjit nr. 49/2012, si dhe në mungesë të një rregullimi kalimtar, pyetja që lind është: Pas datës 4.11.2013, gjykatat civile kanë apo jo kompetencë lëndore për zgjidhjen e çështjeve administrative, që kanë në shqyrtim, ose që presin të shqyrtohen? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë fillimisht çmojnë të marrin në konsideratë gjykatën e caktuar me ligj, në kuptim të gjykatës që është kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

9. Gjykata e caktuar me ligj përmban në vetvete termin “*gjykatë*”, i cili karakterizohet në kuptimin material nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve, të cilat janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. Me këtë parim lidhet, gjithashtu, edhe e drejta e palëve për t’u dëgjuar në seancë nga një gjykatë, kompetenca e së cilës është parashikuar shprehimisht në ligj.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, koncepti gjykatë e caktuar me ligj është konsideruar si element i procesit të rregullt ligjor dhe si i tillë pjesë përbërëse e nenit 42/1 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 23/2009, nr. 7/2009 dhe nr. 31/2005 dhe nr. 16/2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Duke mbajtur parasysh qëndrimin e doktrinës dhe praktikës kushtetuese, paraqitur më lart, për t’iu përgjigjur pyetjes se cila është gjykata e caktuar me ligj, që ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjeve që ligji nr. 49/2012 i përcakton si mosmarrëveshje administrative, shqyrtimi i të cilave nuk ka përfunduar deri në datën 4.11.2013, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të nevojshme që paraprakisht të specifikojë natyrën e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

11. Nëse i referohemi të gjitha dispozitave të ligjit nr. 49/2012, vëmë re se ai nuk është thjesht një ligj organik që rregullon vetëm çështjet e organizimit dhe të funksionimit të gjykatave administrative dhe statusin e gjyqtarëve. Ky ligj parashikon, gjithashtu, edhe parime të përgjithshme të gjykimit administrativ dhe norma procedurale që lidhen me juridiksionin, kompetencën e gjykatave administrative, përbërjen e gjykatave sipas shkallëve të gjykimit dhe natyrës së çështjeve, si dhe fazat procedurale të gjykimit deri në ekzekutimin e vendimit. Pra, në tërësi, ky ligj është me natyrë procedurale.

12. Duke iu rikthyer çështjes së shtruar për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara, këto të fundit vlerësojnë se zbatimi në kohë i ligjit material dhe procedural është i ndryshëm. Ligji material përmban tërësinë e rregullave që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e individëve, personave juridikë dhe imponon sjelljen në një marrëdhënie juridike. Kurse ligji procedural është tërësia e rregullave që përcakton se si gjykata zhvillon procesin gjyqësor, me qëllim respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve ndërgjyqëse, të shprehura në ligjin material. Gjithashtu, ligji procedural u tregon palëve se cila është mënyra që ato të realizojnë të drejtat e tyre duke iu drejtuar gjykatës.

13. Ligji material dhe ai procedural kanë elemente referimi të ndryshme për sa i përket zbatimit të tyre. Zbatimi i ligjit material lidhet me momentin kur ka ndodhur shkelja, kufizimi apo lindja e së drejtës. Për

këtë arsye, si rregull, në rastet kur në fillim apo në vijim të procesit gjyqësor ndryshon ligji material, do të vazhdojë të zbatohet ligji i mëparshëm. Përrjashtim bëjnë rastet kur vetë ligji i ri ka parashikuar fuqinë prapavepruese të tij.

14. Nga ana tjetër, zbatimi i ligjit procedural lidhet me momentin kur zhvillohet gjykimi për shqyrtimin e mosmarrëveshjes para gjykatës. Në ndryshim nga ligji material, ligji procedural do të zbatohet kur gjykata vihet në lëvizje për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje. Nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor të një çështjeje, ligji procedural ndryshon, atëherë në gjykim do të zbatohet ligji i ri, me përjashtim të rastit kur vetë ky ligj në dispozitat kalimtare ka parashikuar që për njëfarë kohe, ose rrethana të caktuara, të vazhdojë zbatimi i ligjit të vjetër procedural.

15. Në funksion të këtij qëndrimi, vjen edhe praktika e Gjykatës Kushtetuese, e cila është shprehur vazhdimisht për kushtetutshmërinë e një procesi duke theksuar se, në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe duke parashikuar dispozita procedurale kalimtare (*shih vendimin nr. 106/2002; nr. 11/2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Sa më sipër, në dispozitat procedurale kalimtare të ligjit të ri procedural, mund të parashikohen çështjet ndaj të cilave ai nuk do t’i shtrijë efektet e menjëhershme, afatin ose kohën gjatë së cilës ky ligj nuk do të veprojë. Në këto raste, i takon ligjvënësit të shprehet lidhur me efektet në kohë të ligjit procedural. Pra, është vetë ligjvënësi, i cili duhet të shprehet se nuk do të zbatohet ligji i ri procedural, por ai i vjetri, gjë që do të thotë se vetë ligji i ri duhet të ketë të përcaktuar qartë se në lidhje me çfarë problemesh dhe deri në çfarë afati kohor do të vazhdojë të zbatohet ligji i vjetër procedural dhe jo ai që është në fuqi. Po kështu, vetë ligji i ri procedural në mënyrë të shprehur duhet të përcaktojë nëse norma e re procedurale nuk do të zbatohet menjëherë, por në një kohë të ardhme, kohë të cilën vetë ligji duhet ta specifikojë. Nëse kjo ndodh, atëherë, pavarësisht se ligji ka hyrë në fuqi, ai nuk i shtrin efektet menjëherë dhe ndaj çështjeve që janë në gjykim¹.

¹ Një mënyrë e tillë në zbatimin e ligjit të ri procedural ka qenë parashikuar në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996. Dispozitat transitorë të ligjit “Për procedurën kontestimore” në Maqedoni parashikojnë zbatimin e ligjit të vjetër procedural në të gjitha shkallët e gjykimit, me përjashtim të rastit kur çështja rifillon përsëri (pra, kthehet për rigjykim). Ndryshe, për shembull, e parashikon ligji “Për zgjidhjen e konflikteve administrative” në Kosovë, në dispozitat transitorë të të cilit parashikohet se ky ligj do të zbatohet nëse është më i favorshëm për palët. Një mënyrë e tillë

17. Duke iu kthyer rastit konkret, fakti që ligji nr. 49/2012 është ligj procedural dhe nuk përmban dispozita kalimtare që të tregojnë se cila është gjendja, faza apo shkalla e gjykimit të një mosmarrëveshjeje gjyqësore mbi të cilën ky ligj i shtrin efektet, atëherë rrjedhimisht pranohet se duke filluar nga data 4.11.2013, ky ligj është i zbatueshëm për të gjitha çështjet që vetë ai i ka përcaktuar si mosmarrëveshje administrative, pavarësisht në çfarë gjendjeje, fazë apo shkallë ndodhet gjykimi.

18. Si rrjedhim, duke nisur nga data 4.11.2013, gjykatat e rretheve gjyqësore, gjykatat e apeleve dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nuk kanë kompetencë lëndore në shqyrtimin e këtyre çështjeve, për këto arsye:

Së pari: Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, gjykatat civile nuk mund të zgjidhin më mosmarrëveshje administrative, për shkak se kompetenca lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative i ka kaluar gjykatave të krijuara për zgjidhjen e tyre me ligjin e posaçëm nr. 49/2012.

Së dyti: Me fillimin e zbatimit të ligjit të posaçëm, pra në datën 4.11.2013, të gjitha dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Civile, ku mbështetej vendimmarrja e gjykatave në zgjidhjen e çështjeve administrative u shfuqizuan. Për këtë arsye, gjykatat civile nuk kanë bazë ligjore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Së treti: Ligji nr. 49/2012 parashikon jo vetëm krijimin e gjykatës së posaçme për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, por edhe parime të ndryshme procedurale mbi bazën e të cilave do të zgjidhen këto mosmarrëveshje. Për këtë arsye, ligji i ri duhet të gjejë zbatim sa më parë për të arritur qëllimin për të cilin ai është miratuar, pra efikasitetin dhe efektivitetin e gjykimit administrativ.

19. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në interpretimin unifikues se: ***Gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me ligjin nr. 49, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit. Këto gjykata janë kompetente për çështjet***

zbatimi të ligjit procedural e kanë të parashikuar, p.sh., dispozitat transitorë të Kodit të Procedurës Civile në Spanjë. Në disa legjisllacione parashikohet edhe mundësia e zbatimit të ligjit procedural sipas shkallëve të procesit gjyqësor, ku ligji i mëparshëm zbatohet deri në fund të gjykimit në një shkallë, ndërsa ligji (i ri) në fuqi zbatohet që nga përfundimi i gjykimit në atë shkallë e më tej.

administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 4.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë, shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma.

20. Lidhur me çështjen e dytë të shtruar për unifikim, nëse gjejnë zbatim parashikimet e neneve 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, për ankimet drejtuar gjykatës së apelit dhe rekursit drejtuar Gjykatës së Lartë përpara datës 4.11.2013, duke qenë se për këtë qëllim nuk ka rregullim të shprehur me dispozitë kalimtare, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vlerësojnë se:

Neni 45 i ligjit nr. 49/2012, parashikon se:

“Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi”.

Neni 56 i ligjit nr. 49/2012, parashikon se:

“Nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit për padi me objekt:

a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi”.

21. Sipas dispozitave të sipërcituara, ligji nr. 49/2012 ka klasifikuar një grup çështjesh, të cilat për shkak të vlerës së vogël të objektit të padisë, nuk mund të ankimohen në një shkallë më të lartë.

Nëse kjo vlerë është më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, Gjykata Administrative e Apelit nuk e pranon çështjen për shqyrtim. Në të njëjtën mënyrë vepron edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në lidhje me çështjet në të cilat vlera e kërkit apo e së drejtës është më e vogël se dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi. Ky rregullim i ri ka natyrë kufizuese në krahasim me rregullimin e mëparshëm të Kodit të Procedurës Civile, që lejonte të drejtën e ankimit apo rekursit, pavarësisht nga vlera e kërkit apo së drejtës që ishte objekt shqyrtimi përpara gjykatës.

22. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se në praktikë ka raste kur subjektet kanë ushtruar tashmë të drejtën e ankimit që ia ka njohur ligji i mëparshëm procedural dhe këto ankime nuk janë shqyrtuar akoma nga gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë, ndërkohë që ligji i ri procedural për këto raste nuk lejon ankimim.

23. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se është i nevojshëm interpretimi i kufizimit të së drejtës së ankimit nga nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012. Kolegjet theksojnë se e drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë është një e drejtë themelore e parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës. Si e tillë, ajo duhet të gjejë shprehje edhe në aktet normative që dalin në bazë dhe për zbatim të dispozitave kushtetuese. E drejta e ankimit mund t'u nënshtrohet kufizimeve me anë të ligjit, duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës. Kriteret e kufizimit sipas kësaj dispozite janë: parashikimi me ligj i kufizimeve, moscenimi i thelbit të së drejtës, mostejkalimi i kufizimeve të vendosura nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe respektimi i parimit të proporcionalitetit në kufizimin e një të drejte themelore.

24. Në rastin konkret, ligji nr. 49/2012, me qëllim kufizimin e së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë, ka vendosur kriter të natyrës financiare, si kusht për të ushtruar të drejtën e paraqitjes së ankimit apo rekursit në një gjykatë më të lartë administrative. Nëse objekti i padisë ka një vlerë më të vogël se ato që parashikohen në nenet 45 dhe 56 të këtij ligji, ankimi ose rekursi nuk lejohen. Në këtë mënyrë, palët në gjykimin administrativ kufizohen në të drejtën e tyre për t'u drejtuar një gjykate më të lartë. Megjithatë, duke iu referuar praktikës sonë kushtetuese, si dhe asaj të Gjykatës Evropiane të së Drejtave të Njeriut (më poshtë "GJEDNJ"), e drejta e ankimit dhe bashkë me të dhe e aksesit në gjykatë, nuk janë të drejta absolute dhe të pakufizueshme. Ato mund të bëhen objekt i kufizimeve nga ligjvënësi, me kusht që të respektohet parimi i proporcionalitetit.

25. Kolegjet e Bashkuara çmojnë se qëllimi i ligjvënësit në vendosjen e këtij pragu në vlerën e padisë,

si kusht për të ushtruar të drejtën e ankimit, ka qenë shmangia e mbingarkesave të gjykimeve të mosmarrëveshjeve administrative me vlerë të vogël padie, duke i dhënë fund gjykimit në shkallë të parë. Ligjvënësi, me ligjin nr. 49/2012, ka bërë kufizim të së drejtës së ankimit, duke mbajtur parasysh interesin publik në shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit administrativ, si dhe vlerën e ulët mbi të cilën zhvillohet ky gjykim. Një gjë e tillë i shërben efektivitetit të gjykimit administrativ, si dhe ekonomisë gjyqësore, si parim që duhet të shtrihet në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor.

26. Megjithëse Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e shohin kufizimin e së drejtës së ankimit në nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012 si të arsyeshëm dhe proporcional, ato vlerësojnë se ky kufizim nuk mund të shtrihet ndaj ankimeve të ushtruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, pasi e kundërta do të cenonte parimin e sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme të individëve nga rendi juridik në fuqi. Palët që kanë paraqitur ankimet dhe rekursit para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012 e gëzonin të drejtën e ankimit të pakufizuar dhe si e tillë ajo duhet të vazhdojë të respektohet nga ligjvënësi dhe gjykatat e të gjitha niveleve.

27. Parimi i gjykatës së caktuar me ligj, i së drejtës së ankimit, si dhe i sigurisë juridike janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën. Si element i sigurisë juridike, mbrojtja e pritshmërive të ligjshme nga rendi juridik ka të bëjë me të drejtën që kanë personat fizikë dhe juridikë për të gëzuar pasojat e pritshme të rendit juridik në fuqi, në kohën kur ata ushtrojnë të drejtat e tyre të ligjshme. Për më tepër, kur këtyre personave i vijnë pasoja të pafavorshme nga ndryshimi i legjislacionit, ky i fundit nuk mund të veprojë me efekt prapaveprues. Parimi i përgjithshëm është se masat me efekte të pafavorshme dhe njëkohësisht prapavepruese janë të ndaluara dhe përjashtimet mund të parashikohen vetëm në rastet kur synohen të mbrohen interesa publike më të larta dhe në raste të përcaktuara qartë nga ligjvënësi.

Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: "*...ligjvënësi duhet të mbajë parasysh se një situatë të rregulluar më parë, parimisht mund ta ndryshojë vetëm nëse kjo sjell pasoja pozitive për subjektet përfituese dhe jo kur ndryshimi i akteve e përkeqëson situatën, pra i heq subjekteve fituese një të drejtë të fituar më parë.....*" (shih vendimin nr. 2/2013; vendimin nr. 9/2007 të Gjykatës Kushtetuese).

28. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë të shprehen edhe lidhur me çështjen nëse kufizimi i së drejtës për t'u ankuar në një gjykatë më të lartë dhe i pritshmërive të ligjshme të qytetarëve është në proporcion me interesin publik për të cilin ligjvënësi ka parashikuar këtë kufizim.

Me qëllim vlerësimin e zbatimit të parimit të proporcionalitetit kur me ligj vendoset një kufizim i një të drejte themelore, duhet të identifikohen interesat publike për të cilat është vendosur masa kufizuese. Në rastin konkret, interesi publik i identifikuar ka të bëjë me nevojën e një administrimi sa më të mirë, efektiv dhe efikas të drejtësisë, duke i dhënë zgjidhje sa më të shpejtë mosmarrëveshjeve administrative dhe arritjen e paqes sociale me kosto sa më të ulët për shtetin dhe publikun.

Nga ana tjetër, renditen interesat e subjekteve, të cilët presin të realizojnë të drejtat e tyre sipas ligjit që ka qenë në fuqi në momentin e ushtrimit të së drejtës së tyre të ankimit ose të rekursit. Gjykatat administrative kanë detyrimin që të shqyrtojnë ankimet ose rekursat, duke qenë se nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, në momentin e paraqitjes së këtyre ankimeve apo rekurseve, nuk kishin hyrë ende në fuqi dhe për këtë shkak nuk mund të sillnin efekte ndaj ankimeve të ushtruara tashmë. Një qëndrim i ndryshëm do të përbënte cenim të parimit të sigurisë juridike në lidhje me realizimin e së drejtës së tyre për t'iu drejtuar një gjykate më të lartë, e drejtë, e cila ishte realizuar në momentin e hyrjes së ligjit të ri në fuqi².

29. Në këto kushte, duke i dhënë përgjigje pyetjes së dytë, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në interpretimin unifikues:

Kufizimet financiare që parashikojnë nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, në lidhje me të drejtën për të paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ ose rekurs në Gjykatë të Lartë, nuk zbatohen në lidhje me ankimet apo rekursat e paraqitura përpara datës 4.11.2013.

30. Në lidhje me çështjen e tretë dhe të katërt të shtruar për diskutim nga ana e Kolegjit Administrativ, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se nuk është rasti për të unifikuar praktikën gjyqësore.

31. Për sa i përket rastit në gjykim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se të dyja gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje të gjitha kërtimeve konkrete në objektin e padisë. Padiësi në kërkimet e tij, përveç detyrimit të palës së paditur të kryejë rillojaritjen e pensionit, ka kërkuar edhe detyrimin e kësaj pale të kthejë diferencat e papaguara nga data 1.8.2005. Ndërkohë, gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj ka urdhëruar palën e paditur që të zbatojë ligjin, pa iu përgjigjur kërtimeve konkrete të palës paditëse, vendim, i cili është lënë në fuqi edhe nga ana e gjykatës së apelit.

32. Ndonëse gjykata e apelit i kishte mundësitë ligjore të ndreqte mangësitë e gjykimit në shkallë të parë, është

mjaftuar vetëm me një përsëritje të arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata ishte e detyruar që t'i jepte një përgjigje konkrete kërtimeve të padiësit dhe jo thjesht të urdhëronte zbatimin e ligjit nga pala e paditur.

33. Ndodhur në këto rrethana, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se në rastin në gjykim ndodhemi përpara kërkesave të nenit 63/c të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", prandaj vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për t'u rishqyrtuar nga një trup tjetër gjykues. Nisur nga interpretimi i mësipërm unifikues, çështja dërgohet për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Në rigjykim, kjo gjykatë duhet të kryejë një hetim të plotë gjyqësor, dhe t'i japë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në padi nga ana e palës paditëse.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 141/2 të Kushtetutës, në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në nenet 17, pika "a" dhe 19§4 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë*",

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr. 678, datë 14.5.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Si gjyqtar në pakicë, kam qëndrimin se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk duhet të kishin disponuar prishjen e vendimit nr. 678, datë 14.5.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, por duhet të kishin vendosur pushimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, për shkak se në çështjen objekt gjykimi, me fillimin e efekteve të zbatimit të ligjit nr. 49/2012, për shkak të vlerës së padisë nën kufijtë e treguar nga shkronja "ç" e nenit 56 të këtij ligji, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është i paankimueshëm në Gjykatën e Lartë.

Qëndrimi im i kundërt me shumicën e Kolegjeve të Bashkuara, lidhur me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, është rrjedhojë logjike e qëndrimit tim konsekuent mbi kuptimin dhe interpretimin e parimeve dhe dispozitave kushtetuese, i cili më rezultoi pjesërisht i kundërt me ato të shumicës së Kolegjeve, kjo për sa i përket arsyetimit dhe përfundimeve unifikuese të ardhura nga këto Kolegje të Bashkuara mbi çështjet e interpretimit dhe zbatimit të

² Një qëndrim të tillë, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut e ka mbajtur në shumë nga vendimet e saj, si: Petko Petkov v. Bulgaria, no. 2834/06, 19.2.1013, pg. 29, 32; Legrand v. Francë, no. 23228/08, 26.5.2011; Hoare v. the United Kingdom, no. 16261/08, 12.5.2011.

unifikuar të ligjit, të ngritura në pyetjen e dytë dhe të tretë të parashtruar para këtyre Kolegjeve.

1. Për çështjen e parë të shtruar për unifikim

Qëndrimi im mbi interpretimin e parimeve dhe normave kushtetuese e të atyre procedurale civile është i njëjtë dhe i shprehur plotësisht në arsyetimin e parashtruar dhe përfundimet unifikuese të ardhura nga shumica e Kolegjeve të Bashkuara, lidhur me çështjet e interpretimit të ligjit të lindura nga pyetja e parë që është shtruar për unifikim, për sa i përket gjykatës kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Kështu, me të drejtë, në pikat 9 deri 15 të vendimit të këtij vendimi të Kolegjeve të Bashkuara, për të ardhur në përfundimin e parë unifikues të saj, mes të tjerave, arsyetohet se:

“.....zbatimi i ligjit procedural lidhet me momentin kur zhvillohet gjykimi për shqyrtimin e mosmarrëveshjes para gjykatës. Nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor të një çështjeje, ligji procedural ndryshon, atëherë në gjykim do të zbatohet ligji i ri, me përjashtim të rastit kur vetë ky ligj në dispozitat kalimtare ka parashikuar që për njëfarë kohe ose rrethana të caktuara, të vazhdojë zbatimi i ligjit të vjetër procedural.....

..... edhe praktika e Gjykatës Kushtetuese, e cila është shprehur vazhdimisht për kushtetutshmërinë e një procesi duke theksuar, se në të drejtën procedurale ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe duke parashikuar dispozita procedurale kalimtare. (Shih vendimin nr. 106/2002; nr. 11/2009 të Gjykatës Kushtetuese)....

.... është vetë ligjvënësi, i cili duhet të shprehet se nuk do të zbatohet ligji i ri procedural, por ai i vjetri, gjë që do të thotë se vetë ligji i ri duhet të ketë të përcaktuar qartë se në lidhje me çfarë problemesh dhe deri në çfarë afati kohor do të vazhdojë të zbatohet ligji i vjetër procedural dhe jo ai që është në fuqi....

....fakti që ligji nr. 49/2012 është ligj procedural dhe nuk përmban dispozita kalimtare që të tregojnë se cila është gjendja, faza apo shkalla e gjykimit të një mosmarrëveshjeje gjyqësore mbi të cilën ky ligj i shtrin efektet, atëherë rrjedhimisht pranohet se duke filluar nga data 4.11.2013, ky ligj është i zbatueshëm për të gjitha çështjet që vetë ai i ka përcaktuar si mosmarrëveshje administrative, pavarësisht në çfarë gjendjeje, fazë apo shkallë ndodhet gjykimi....

....Ligji nr. 49/2012 parashikon jo vetëm krijimin e gjykatës së posaçme për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, por edhe parime të ndryshme procedurale mbi bazën e të cilave do të zgjidhen këto mosmarrëveshje.”

2. Për çështjen e dytë të shtruar për unifikim

Si gjyqtar në pakicë, kam mendim të kundërt me

shumicën e Kolegjeve të Bashkuara lidhur me mënyrën e arsyetimit dhe përfundimet e ardhura prej shumicës në lidhje me çështjet e interpretimit dhe zbatimit të unifikuar të ligjit, të parashtruara në pyetjen e dytë, pra nëse kufizimet e parashikuara nga normat procedurale të ligjit nr. 49/2012 mbi të drejtën e ankimit do të kenë efekt edhe për ankimet e rekursit e paraqitura përpara datës 4.11.2013.

Pavarësisht se ka arsyetuar dhe konkluduar në mënyrë ezauruese se në gjykimin civil zbatohet ligji procedural që është në fuqi në kohën e gjykimit dhe, përjashtimisht, kur kjo parashikohet shprehimisht nga ligji me dispozitë kalimtare, gjen zbatim ligji i vjetër (i shfuqizuar) procedural, shumica e Kolegjeve të Bashkuara mban qëndrim krejt të kundërt në lidhje me ligjin procedural të zbatueshëm në kohë për sa i përket së drejtës së ankimit dhe shqyrtimit të ankimit nga gjykatat administrative.

Këtë qëndrim të saj, shumica e Kolegjeve të Bashkuara e mbështet në arsyetimin fillimisht korrekt se, nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, me të cilat, në varësi të vlerës së padisë, nuk lejohet ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo ndaj atij të gjykatës së apelit, kanë natyrë kufizuese për sa i përket së drejtës së ankimit në krahasim me rregullimin e mëparshëm të Kodit të Procedurës Civile, që lejonte të drejtën e ankimit apo rekursit pa kufizime, pra pavarësisht nga vlera e kërimit apo e së drejtës që ishte objekt shqyrtimi përpara gjykatës.

Po kështu, me të drejtë nga shumica e Kolegjeve të Bashkuara pohohet e konkludohet se kufizimi i së drejtës së ankimit me nenet 45 dhe 56 përmbushin kriteret kushtetuese, duke qenë kufizime të arsyeshme dhe proporcionale.

Megjithatë, pavarësisht nga sa kanë arsyetuar më parë mbi natyrën dhe veprimin në kohë të ligjit procedural civil, shumica e Kolegjeve të Bashkuara, duke u konfondeuar dhe aplikuar gabimisht elemente të gjykimit kushtetues mbi shqyrtimin e kushtetutshmërisë së normës së ligjit abstrakt që i përket ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese, vijojnë arsyetimin e tyre dhe vijnë në përfundimin se këto kufizime të së drejtës së ankimit nuk mund të shtrihen ndaj ankimeve dhe rekurseve të ushtruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, pasi e kundërta do të cenonte parimin e sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme të individëve nga rendi juridik në fuqi. Sipas shumicës, palët që kanë paraqitur ankimet dhe rekursit para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012 e gëzonin të drejtën e ankimit të pakufizuar dhe si e tillë ajo duhet të vazhdojë të respektohet në gjykatat e të gjitha niveleve. Madje shumica e Kolegjeve, për vetë mënyrën si arsyeton dhe termat e përdorur, duket sikur largohet nga fusha e saj e përcaktuar e interpretimit të ligjit, kur njësoj si një gjykatë kushtetuese i adresohet me këtë

udhëzim të detyrueshëm jo vetëm gjykatave, por edhe vetë ligjvënësit, kur shprehet se kjo e drejtë duhet "...të respektohet nga ligjvënësi...".

Edhe referenca e treguar në pikën 27 të vendimit, për mbështetjen e arsytimit të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara në vendimet nr. 2/2013 dhe nr. 9/2007 të Gjykatës Kushtetuese, në të vërtetë tregon se Gjykata Kushtetuese është shprehur aty jo për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat, por i adresohet ligjvënësit, pikërisht lidhur me parimet kushtetuese që ligjvënësi duhet të mbajë parasysh kur harton dhe miraton ligje të reja, që synojnë të kufizojnë të drejtat e njohura dhe të fituara më parë me ligj nga subjektet përfituese.

Me të njëjtën përjasje, pra me elemente që duket se i përkasin gjykimit kushtetues, shumica e Kolegjeve të Bashkuara arsyeton edhe në pikat 28 dhe 29 të vendimit, në të cilat, ndonëse ligji nr. 49/2012, as në nenet 45 e 56 të tij dhe as në dispozitat kalimtare, nuk parashikon shprehimisht ndryshe, vjen në përfundimet se "*Gjykatat administrative kanë detyrimin që të shqyrtojnë ankimet ose rekursat, duke qenë se nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, në momentin e paraqitjes së këtyre ankimeve apo rekurseve, nuk kishin hyrë ende në fuqi dhe për këtë shkak nuk mund të sillnin efekte ndaj ankimeve të ushtruara tashmë. Një qëndrim i ndryshëm do të përbënte cenim të parimit të sigurisë juridike në lidhje me realizimin e së drejtës së tyre për t'iu drejtuar një gjykate më të lartë, e drejtë, e cila ishte realizuar në momentin e hyrjes së ligjit të ri në fuqi*".

Duke arsyetuar në këtë mënyrë, madje në kundërshtim me qëndrimet e saj të qarta e korrekte për interpretimin e ligjit procedural në përgjigje të pyetjes së parë unifikuese, pa u shprehur haptazi se gjenden para një lloj ometimi kushtetues (pra, mungesës së dispozitës kalimtare që do të mënjanonte cenimin e parimit kushtetues të sigurisë juridike të lidhur me ushtrimin e së drejtës së ankimit në gjykatë), duket se shumica e Kolegjeve të Bashkuara orienton gjykatat të mos mbajnë më parasysh se ligjvënësi nuk ka dashur të miratojë një dispozitë kalimtare që lejon zbatimin e normës së vjetër procedurale e jo atë që është në fuqi, për sa i përket së drejtës së ankimit në gjykatën më të lartë.

Si gjyqtar në pakicë, kam mendimin se Gjykata e Lartë është gjykatë ligji. Si çdo gjykatë tjetër, ajo mbështet në vendimet e dhëna prej saj në Kushtetutë dhe në ligj, duke pasur, pra, të drejtën dhe detyrimin vetëm që të interpretojë dhe të zbatojë normat kushtetuese e ligjore në zgjidhjen e çështjes. Në këtë kuptim, gjykatat kanë të drejtën e detyrimin të interpretojnë dhe të arsyetojnë, bazuar në normat kushtetuese dhe ligjore në funksion të zgjidhjes së çështjes, por ato nuk mund të injorojnë a të refuzojnë të zbatojnë ligjin procedural

nëse kanë qëndrimin se ai ligj vjen në kundërshtim me Kushtetutën apo me motivin e mungesës së parashikimit të shprehur të një rregullimi ligjor procedural të caktuar. Gjykatat nuk bëjnë gjykim kushtetues mbi ligjin abstrakt. Në raste të tilla, sikurse parashikon pika 2 e nenit 145 të Kushtetutës "*Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese*". Pra, vetëm gjykatat mbajnë qëndrimin e tyre duke parashtruar arsyet përse mendojnë se një dispozitë ligjore nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe përse nuk mund ta zgjidhin çështjen pa u shprehur më parë Gjykata Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e asaj norme juridike të ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes që ka për shqyrtim.

Si gjyqtar në pakicë, konkludoj se shumica e Kolegjeve të Bashkuara, duke e tejkualuar kufirin e gjykimit që i lejohet atyre si gjykatë ligji dhe jo si gjykatë kushtetuese, për interpretimin normal të Kushtetutës dhe të normave të ligjit procedural objekt unifikimi, nuk kanë bërë gjë tjetër veçse kanë konkluduar të mos e zbatojnë kufizimin e vendosur shprehimisht në nenet 45 e 56 të ligjit nr. 49/2012 lidhur me të drejtën e ankimit, ndonëse pranojnë vetë se mungon një dispozitë kalimtare e shprehur, që lejon shqyrtimin e ankimeve, që nuk plotësojnë kriteret e neneve 45 e 56, por që janë paraqitur para datës 4.11.2013. Aq më tepër kjo bie ndesh me vetë qëndrimin e shumicës së Kolegjeve të Bashkuara, të cilat, për çështjen e parë unifikuese, pa asnjë ekuivok, arsyetojnë dhe konkludojnë që ligji i vjetër procedural zbatohet vetëm kjo parashikohet shprehimisht me dispozitë kalimtare.

Në linjën logjike juridike të arsytimit të tyre, se kufizimi me një ligj të ri të së drejtës së ankimit në gjykatën më të lartë të fituar me ligjin e mëparshëm procedural do të përbënte cenim të parimit kushtetues të sigurisë juridike etj., dhe në mungesë të një norme kalimtare që mënjanon këtë shkelje kushtetuese, si gjykatë ligji, shumica e Kolegjeve të Bashkuara mund të ushtronte vetëm kompetencën e saj që i njihte Kushtetuta (neni 145/2) për t'ia dërguar çështjen Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit abstrakt.

Si gjyqtar në pakicë, duke mbetur konsekuent në qëndrimin tim lidhur me natyrën e ligjit procedural civil dhe parimet e veprimit në kohë të tij, i cili është shprehur qartë edhe në arsytimin e përfundimit e Kolegjeve të Bashkuara në përgjigjen për pyetjen e parë të shtruar për unifikim, kam mendimin se ligjvënësi, me vullnet të shprehur qartë, nuk ka dashur të parashikojë ndonjë dispozitë kalimtare që, përjashtimisht, nga sa parashikohet në nenet 45 e 56 të ligjit nr. 49/2011, t'i

japë fuqi rregullit procedural të mëparshëm dhe të lejojë zbatimin e së drejtës së pakufizuar të ankimit ndaj vendimeve gjyqësore me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative për ankimet e rekursit e paraqitura nga palët përpara datës 4.11.2013. Prandaj, këto ankime dhe rekurse nuk mund të shqyrtohen më, përkatësisht, nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

3. Për çështjen e tretë të shtruar për unifikim

Në pikën 30 të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara, shumica arsyeton se *“Në lidhje me çështjen e tretë dhe të katërt të shtruar për diskutim nga ana e Kolegjit Administrativ, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se nuk është rasti për të unifikuar praktikën gjyqësore”*.

Si gjyqtar në pakicë kam qëndrim të kundërt me shumicën, kjo duke u nisur nga qëndrimi konsekuent dhe logjik që kam mbajtur për interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit procedural lidhur me dy çështjet e para për unifikim, veçanërisht për çështjen e dytë.

Sipas mendimit tim, kufizimi i së drejtës së ankimit nisur nga vlera e padisë gjen zbatim të menjëhershëm pas datës 4.11.2013. Për rrjedhojë, nisur nga ky qëndrim, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kanë detyrimin për të verifikuar, rast pas rasti, nëse vlera e padisë apo e kërkesës në çështjen e ankimit me apel ose rekurs, është apo jo nën vlerën minimale, të përcaktuar sipas neneve 45 e 56 të ligjit nr. 49/2011. Nëse vlera do të ishte më e ulët duhet të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes.

Kam mendimin se interpretimi i unifikuar i neneve 46 e 56 për sa i përket mënyrës se si duhet të përcaktohet vlera e padisë, jo vetëm është vendimtar për të garantuar sigurinë juridike në shqyrtimin e ankimeve dhe rekurseve, por është e lidhur drejtpërdrejt me vetë zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, në të cilën, objekt mosmarrëveshje administrative është kërkimi dhe njohja e një detyrimi periodik e të papërcaktuar në shtrirje kohore, pikërisht kërkimi për detyrimin e palës së paditur të njohë dhe të shlyejë pagesën e pensionit suplementar të ushtarakut sipas ligjit dhe jo në masën që ka caktuar pala e paditur.

Në nenin 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012 parashikohet se nuk lejohet, përkatësisht, ankim dhe rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative shkallës së parë dhe të apelit, për padi me objekt kundërshtim i akteve administrative a mosmarrëveshje administrative me vlerë më të vogël se njëzetfishi dhe dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi.

Paga minimale në shkallë vendi, sipas legjislacionit në fuqi, dihet se përcaktohet periodikisht çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Vendimi i fundit i qeverisë, ai me

nr. 537, datë 3.7.2013, përcakton se paga minimale në shkallë vendi është 22.000 lekë.

Rrjedhimisht, vlera minimale e padisë për efekt të zbatimit të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 është 440.000 lekë, ndërsa për nenin 56 është 880.000 lekë.

Por, ndërkohë që për mënyrën e përcaktimit të vlerës së padisë, në rastet e tjera të neneve 45 e 56, jemi para vlerave të përcaktueshme dhe për të cilat, gjithsesi, ligji material e procedural dhe praktika gjyqësore njeh mekanizmat përkatës të identifikimit, në lidhje me shkronjën “ç” të këtyre neneve, e më konkretisht lidhur me *“sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”*, ku parashikohen detyrime të natyrës periodike, si gjyqtar në pakicë, kam mendimin se gjykatat do të gjenden në vështirësi për të përcaktuar vlerën e padisë për efekt të pranueshmërisë për shqyrtim të ankimit ose rekursit. Kjo për faktin se ligji nr. 49/2012 nuk përmban ndonjë dispozitë konkrete ku të tregohen kriteret e përllogaritjes së vlerës së padisë për detyrimet periodike, sikurse janë ato të parashikuara në shkronjën “ç” të nenit 45 dhe 56. Por, sipas parimit të njohur procedural civil se gjykata nuk mund të refuzojë shqyrtimin e çështjes me arsyetimin se ligji mungon, gjykatës i lind detyrimi të gjejë vetë bazën dhe arsyet ligjore për zgjidhjen e çështjes.

Në këtë kontekst, si gjyqtar në pakicë vlerësoj se përmbushja e detyrimit për identifikimin e parimeve dhe normave të zbatueshme duhet të kërkohet në legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhënie apo çështje të ngjashme e të përafërta.

Nga shqyrtimi i legjislacionit në fuqi, si gjyqtar në pakicë, nisur nga natyra periodike e detyrimit për të cilin ngrihet padia, më rezulton se e vetmja normë procedurale me parime dhe rregullim të përafërt është ajo e paragrafit të parë të nenit 67 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“Në rastin e kërkimit të një detyrimi ushqimor periodik, kur titulli kundërshtohet, vlera përcaktohet në bazë të shumës së përgjithshme që duhet të jepet për dy vjet”*.

Sipas kësaj dispozite, meqenëse detyrimi ushqimor është periodik, për efekt të përcaktimit të vlerës së padisë, shuma e saj llogaritet me detyrimin ushqimor që do të përfitojë për një periudhë dyvjeçare.

Por, kam mendimin se, nisur nga natyra e posaçme e mënyrës së llogaritjes dhe përditësimit të pensioneve dhe përfitimeve periodike të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, deri në miratimin në të ardhmen nga ligjvënësi të një rregullimi të posaçëm procedural të shprehur në ligj, Kolegjet e Bashkuara duhet të bënin interpretim unifikues të ligjit, duke e llogaritur vlerën e padisë mbi masën e pensionit ose përfitimit që do të merrej për një periudhë vetëm njëvjeçare, sipas masës përkatëse të përcaktuar nga ligjvënësi për atë vit buxhetor. Kjo për shkakun se masa e pensioneve dhe përfitimeve nga sigurimet shoqërore e

shëndetësore ndryshojnë vijimësisht, në çdo vit buxhetor, si rregull duke u rritur, për shkak të indeksimit të inflacionit dhe për motive të tjera që i vlerëson vit pas viti qeveria dhe i miraton ligjvënësi. Në këtë kuptim, kur vetë ligjvënësi rishikon çdo vit masën e përfitimeve dhe pensione nga sigurimet shoqërore e shëndetësore, atëherë edhe gjykata nuk mund t'i njohë vetes të drejtën të llogarisë vlerën e padisë mbi parametra statikë përtej një periudhe njëvjeçare.

4. Për zgjidhjen e çështjes

Për sa i përket zgjidhjes së çështjes, objekt i këtij gjykimi para Kolegjeve të Bashkuara, si gjyqtar në pakicë, nisur nga arsyet dhe qëndrimet e parashtruara më sipër lidhur me interpretimin e zbatimin e ligjit për tri çështjet e para të shtruar për unifikim, kam arsyetim dhe përfundim të kundërt me shumicën e Kolegjeve.

Kështu, me anë të padisë, paditësi Enver Ajdari ka kundërshtuar masën e pensionit të parakohshëm që i ka caktuar pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, duke kërkuar detyrimin e së paditurës të bëjë rillogaritjen e këtij pensioni sipas ligjit në fuqinë kohën e fitimit të pensionit, nga data 1.8.2005, duke u detyruar njëkohësisht t'i kthejë diferencat e papaguara që ngakjo datë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka pranuar padinë, vendim, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, i cili është paraqitur përpara datës 4.11.2013, ditë në të cilën kanë filluar efektet e ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Nga pranimi i rrethanave të faktit, të bëra nga gjykatat më të ulëta, rezulton se paditësi Enver Ajdari pretendon se masa e pensionit mujor që i takon sipas ligjit në fuqi në datën 1.8.2005 është 47.370 lekë. Ndërsa masa e pensionit mujor që i përcakton pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, është 15.963 lekë.

Pikërisht, me anë të padisë, pala paditëse Enver Ajdari kërkon të detyrohet pala e paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore t'i bëjë rillogaritjen e pensionit dhe t'i shlyejë diferencat e papaguara të pensionit mujor duke filluar nga data 1.8.2005 e në vazhdim.

Sipas një llogaritje të thjeshtë matematikore, e cila nuk kërkon njohuri të posaçme shkencore të kësaj fushe, rezulton e pranuar nga gjykatat e faktit se diferenca e masës së pensionit mujor që paditësi pretendon me anë të padisë se duhet t'ia njohë dhe t'ia shlyejë pala e paditur që nga data 1.8.2005 dhe në mënyrë periodike në të ardhmen është: $47.370 \text{ lekë} - 15.963 \text{ lekë} = 32.407 \text{ lekë}$.

Nëse, në mungesë të kriterit të parashikuar nga vetë ligji, si kriter për llogaritjen e vlerës së padisë në çështjen objekt gjykimi do të aplikohet ai i periudhës njëvjeçare, kjo sipas qëndrimit tim të parashtruar më sipër si gjyqtar në pakicë lidhur me pyetjen e tretë unifikuese, atëherë vlera e padisë

do të rezultonte në masën: $32.407 \text{ lekë} \times 12 = 388.884 \text{ lekë}$.

Kjo vlerë është dukshëm më e vogël sesa kufiri i parashikuar, aktualisht prej 880.000 lekë (dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi), nga neni 56 i ligjit nr. 49/2012, për efekt të pranueshmërisë për gjykim të rekursit të ushtruar kundër vendimit të gjykatës së apelit.

Por edhe nëse do të aplikohet vetë kriteri analog i parashikuar në nenin 67 të Kodit të Procedurës Civile, pra ai i periudhës dyvjeçare, vlera e padisë në çështjen objekt gjykimi do të rezultonte në masën: $32.407 \text{ lekë} \times 24 = 777.768 \text{ lekë}$.

Edhe kjo vlerë rezulton të jetë më e vogël sesa kufiri i parashikuar, aktualisht prej 880.000 lekësh (dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi), nga neni 56 i ligjit nr. 49/2012 për efekt të pranueshmërisë për gjykim të rekursit të ushtruar kundër vendimit të gjykatës së apelit.

Në të tilla rrethana, për të gjitha arsyet e parashtruara dhe të analizuara më sipër, të cilat gjykoj se duhet të përbënin edhe objektin e interpretimit të drejtë dhe të unifikuar të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si edhe për shkak se vendimi nr. 678, datë 14.5.2009 i Gjykatës së Apelit Tiranë është i paankimueshëm në Gjykatën e Lartë, kjo në zbatim të kufizimit të ankimit, nisur nga vlera më e vogël e padisë objekt i këtij gjykimi, krahasuar me pagën minimale në shkallë vendi, të parashikuar nga dispozita e nenit 56 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

si gjyqtar në pakicë, kam qëndrimin se Kolegjet e Bashkuara duhet të kishin vendosur:

"Pushimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë".

Gjyqtar: Ardian Dvorani

MENDIM PAKICE

Unë, gjyqtari në pakicë, **Medi Bici**, në bazë të nenit 307/2 të Kodit të Procedurës Civile, parashtroj me shkrim mendimin tim kundër, për t'ia bashkëngjitur vendimit nr. 3, datë 6.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes ka rezultuar e provuar si më poshtë:

Pala paditëse, Enver Ajdari, ka qenë ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me gradën nënkolonel, vjetërsi shërbimi mbi 30 vjet dhe pagë referuese 62.600 lekë.

Pala e paditur i ka lidhur palës paditëse një pension të parakohshëm në shumën 15.693 lekë në muaj, i cili fillonte nga data 1.8.2005 dhe do të vazhdonte derisa pala paditëse të arrinte moshën për përfundimin e pensionit të plotë të pleqërisë.

Meqenëse pala paditëse ka pasur pretendime për masën e pensionit të parakohshëm, i është drejtuar palës tjetër si organi administrativ kompetent dhe pasi nuk ka marrë zgjidhje prej tij, duke ezauruar më parë rrugën administrative të ankimit, i është drejtuar rrugës gjyqësore për zgjidhjen e çështjes.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë, vendim, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, ndaj të cilëve ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

Në datën 4.11.2013 në Republikën e Shqipërisë kanë filluar aktivitetin e tyre gjykatat administrative, prandaj Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë caktoi datën e seancës për shqyrtimin e çështjes nga Dhoma e Këshillimit, e cila e dërgoi atë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njësimin e praktikës gjyqësore, duke shtruar për zgjidhje katër çështje konkrete.

Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me ligjin nr. 49, datë 3.5.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 4.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatën e Lartë dhe deri në këtë datë shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma.

Pakica vlerëson se përfundimi që kanë arritur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me këtë çështje është i pabazuar në ligj për arsyet e mëposhtme:

Vendimi unifikues nr. 3, datë 6.12.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë bie në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative"..., i cili ndërmjet të tjerave përcakton se:

Gjykata Administrative e Apelit gjykon me trup gjyqësor të përbërë nga tre gjyqtarë ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë.

Nga citimi pjesërisht i dispozitës ligjore të mësipërme del qartë se vullneti i ligjvënësit ka qenë se Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në asnjë rrethanë nuk mund të disponojnë mbi vendimet e marra nga gjykatat e rretheve gjyqësore, ose të apeleve në rastin e shqyrtimit të rekurseve, pasi kompetencën lëndore për këtë e kanë gjykatat e apeleve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ose Kolegjet e Bashkuara të

Gjykatës së Lartë në rastin e shqyrtimit të çështjes prej tyre.

Sipas shumicës, Gjykata e Apelit Administrativ mund të disponojë mbi vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mund të disponojë mbi vendimet që kanë dhënë gjykatat e apeleve të Republikës, qëndrim, i cili është në kundërshtim me ligjin, pasi kompetencat në lëndë ndërmjet gjykatave administrative dhe gjykatave civile janë krejtësisht të ndara dhe nuk ka asnjë rast që ligji lejon interferimin të njëra-tjetra.

Në ndihmë të arsytimit që bën pakica, vjen edhe vendimi unifikues nr. 1, datë 16.4.2004 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku ndërmjet të tjerave ato shprehen:

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nuk mund të shqyrtojë në shkallë të dytë çështje që janë shqyrtuar në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore (parimi i vazhdimësisë së gjykimit).

Vërtet me këtë vendim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë bërë njësimin e praktikës gjyqësore për çështje që i takojnë fushës që rregullon Kodi i Procedurës Penale, por parimi mbetet i njëjtë, pasi ndodhemi në të njëjtat rrethana (përpara krijimit të gjykatave të reja), të cilat gjykojnë çështje të një fushe të caktuar, prandaj Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet ta mbanin parasysh në dhënien e vendimit praktikën gjyqësore që ato kishin bërë më parë, sepse në rastin objekt gjykimi për çështje të ngjashme ato kanë mbajtur qëndrim të ndryshëm nga i pari, duke e çorientuar praktikën gjyqësore të unifikuar më parë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nëse vlerësonin se praktika gjyqësore e mëparshme duhej ndryshuar, në përputhje me nenin 19 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë" (i ndryshuar), atëherë ato duhet ta bënin çështjen objekt diskutimi në seancë gjyqësore dhe, më pas, të dilnin me një vendim përfundimtar.

Në nenin 1/2 të ligjit nr. 49/2012, është përcaktuar se:

Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

Pakica vlerëson se për të plotësuar boshllëkun, që mund të krijonte ligji nr. 49/2012, ligjvënësi ka parashikuar që në zgjidhjen e çështjeve administrative gjykatat administrative, krahas ligjit të tyre organik, mund të zbatojnë edhe dispozitat ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, duke përjashtuar rastin kur ligji organik parashikon ndryshe.

Në rastin në gjykim nuk jemi përpara rastit të ndalimit, pasi ligji organik nuk parashikon ndonjë ndalim që nuk zbatohet rregullat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, i cili me ndryshimet e pësuara nga ligji nr. 122/2013 parashikon se çështjet që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të ligjit do të gjykohen sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesëpadisë dhe përderisa ligji nr. 49/2012 referon në Kodin e Procedurës Civile, i cili nuk ka ndalim, atëherë për

çështjet e filluara nga gjykatat e rretheve gjyqësore përpara datës 4.11.2012, duhet të zbatoheshin rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Së fundmi, vendimi unifikues nr. 3, datë 6.12.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për pikën e parë të tij bie ndesh edhe me vetë qëllimin e ligjit me të cilin u krijuan gjykatat administrative, pasi sipas tij ato u krijuan për të zgjidhur konfliktet ndërmjet personave juridikë, personave fizikë dhe administratës shtetërore brenda një kohe sa më të shkurtër, duke përcaktuar edhe afatet përkatëse për çdo shkallë gjykimi.

Çështjet e regjistruara në gjykatat e shkallës së parë përpara datës 4.11.2012, në pjesën më të madhe të tyre i kanë kaluar afatet e shqyrtimit që parashikohen në ligjin nr. 49/2012, prandaj shqyrtimi i tyre nga gjykatat administrative, jo vetëm që do të ishte i paligjshëm, por kjo do të çonte edhe në injorimin e afateve të gjykimit për çështjet e regjistruara në gjykatat administrative pas datës 4.11.2012, duke e bërë veprimtarinë e tyre të paligjshme që në fillim, për shkak të shkeljes së afateve të gjykimit të parashikuar në ligj.

Me këtë arsytim, pakica arrin në përfundimin se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për këtë pikë duhet ta njësonin praktikën gjyqësore në këtë mënyrë:

Çështjet e regjistruara përpara datës 4.11.2012 në gjykatat e rretheve gjyqësore duhet të vazhdonin të gjykoreshin po nga ato gjykata dhe ankimet ndaj vendimeve të tyre duhet të shqyrtoheshin nga gjykatat e apeleve, kurse rekursat ndaj vendimeve të këtyre të fundit duhet të shqyrtoheshin nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e kanë njësuar praktikën gjyqësore si më poshtë:

Kufizimet financiare që parashikojnë nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012 në lidhje me të drejtën për të paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, ose rekurs në Gjykatën e Lartë, nuk zbatohen në lidhje me ankimet apo rekursat e paraqitura përpara datës 4.11.2013.

Pakica vlerëson se qëndrimi që ka mbajtur shumica bie në kundërshtim me pikën e parë të unifikuar prej saj, sepse nga njëra anë ajo thotë që për çështjet dhe ankimet ndaj vendimeve të regjistruara përpara datës 4.11.2012 duhet të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 49/2012 dhe, nga ana tjetër, kur vjen puna për të zbatuar konkretisht parashikimet e neneve 45 dhe 56 të këtij ligji në rastet e ankimeve të paraqitura më parë, ajo thotë se nuk duhen zbatuar këto dispozita ashtu siç janë shkruar, çka përbën një nonsens, sepse përderisa çështjet e regjistruara përpara datës 4.11.2013 iu kaluan gjykatave administrative, atëherë këto të fundit duhet të zbatojnë merigorozitet të gjitha parashikimet e ligjit organik.

Duke vepruar në këtë mënyrë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë lënë pa fuqi pjesërisht këto dy dispozita ligjore, duke kapërcyer në këtë mënyrë

kompetencat që atyre u jep ligji, pasi nuk është në kompetencë të Gjykatës së Lartë ndryshimi ose shfuqizimi i dispozitave ligjore, por ajo është e detyruar që t'i zbatojë ato.

Pakica është dakord me qëndrimin e shumicës se ankimi i bërë më parë është një e drejtë e fituar dhe sipas vendimeve nr. 2/2013 dhe nr. 9/2007 të Gjykatës Kushtetuese, kjo situatë mund të ndryshojë vetëm nëse subjektet përfituese kanë pasoja pozitive, por në çështjen objekt gjykimi, zbatimi i ligjit të ri sjell pasoja negative për subjektin përfitues, prandaj ky fakt duhet të shërbente si një nga arsyet që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ta njësonin praktikën gjyqësore në atë mënyrë që shqyrtimi i çështjeve në gjykim përpara momentit të funksionimit të gjykatave administrative duhet të rregullohej sipas dispozitave ligjore të K.Pr.Civile, gjë e cila do të zgjidhte fare mirë edhe moscenimin e të drejtave të fituara nga palët për ankimet dhe rekursat e paraqitura ndaj vendimeve të gjykatave përpara datës 4.11.2013.

Në lidhje me mosunifikimin e dy çështjeve të tjera, të shtruara përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat kishin të bënin me kriteret e përlllogaritjes së vlerës së njëzetfishit ose dyzetfishit të pagës minimale në shkallë vendi dhe interpretimin e neneve 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012, si dhe kthimin e çështjes konkrete për rishqyrtim në apel, pakica ka të njëjtin qëndrim me shumicën, por ajo ndahet me të në faktin se çështja duhej t'i dërgohej për rishqyrtim Gjykatës së Apelit Tiranë dhe jo Gjykatës Administrative të Apelit, pasi ajo është regjistruar përpara datës së fillimit të veprimtarisë së gjykatave administrative.

Arsyetimi i mësipërm e çon pakicën në përfundimin se vendimi nr. 3, datë 6.12.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në pjesën që njëson praktikën gjyqësore (pikat 1 dhe 2 të tij), si dhe për dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit është i pabazuar në ligj, prandaj për këto pjesë, vota ime është kundër tij.

Gjyqtar: Medi Bici

MENDIM PAKICE

Ne gjyqtarët e pakicës shprehemi kundër vendimit të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për arsyet e mëposhtme.

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, parashikon krijimin e gjykatave administrative. Këto gjykata, nëpërmjet këtij ligji, u krijuan rishtazi. Parashikimet e këtij ligji lidhur me organizimin, funksionimin e gjykatave administrative, me parimet dhe procedurën e gjykimit, palët në proces dhe personat e tjerë në gjykimin administrativ, rezultojnë përgjithësisht të reja dhe të ndryshme nga ato të deritanishme.

Në këtë aspekt, ne çmojmë se nga ana e ligjvënësimit nuk rezultojnë qëllimi që çështjet e regjistruara për gjykim në gjykatat e të gjitha niveleve, që sipas nenit 7 të këtij ligji i përkasin kompetencës lëndore të gjykatave administrative, në momentin e hyrjes së ligjit në fuqi (datë 4.11.2013) të kalonin për gjykim (pavarësisht fazës së gjykimit që ndodheshin) në gjykatat administrative të sapokrijuara. Në funksion të idesë së mësipërme, vlen të përmendim, gjithashtu, dhe faktin e mungesës së një dispozite kalimtare në ligjin nr. 49/2012 lidhur me fatin e çështjeve të regjistruara në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Gjë e cila nënkupton se këto çështje do të vazhdojnë të gjykojnë nga gjykatat, të cilat kanë kompetencën funksionale, pra nga gjykatat e zakonshme, me ligjin e kohës së regjistrimit të tyre për gjykim.

Vlerësojmë se parimi i së drejtës procedurale se ligji procedural është menjëherë i aplikueshëm, nuk është i zbatueshëm për çështjet civile të regjistruara në gjykatat e zakonshme në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012 dhe që sipas nenit 7 të tij lidhen me mosmarrëveshje që i përkasin kompetencës lëndore të gjykatave administrative.

Mendojmë se aplikimi në mënyrë të menjëhershme i ligjit procedural në një proces gjyqësor tashmë të filluar, mund të jetë i zbatueshëm vetëm në rastet kur ligji i ri rregullon çështje të parregulluara më parë apo kur ndryshon një rregullim të mëparshëm të një çështjeje të caktuar, nëse për këtë ligjvënësi nuk vendos që rregullat e reja janë të aplikueshme vetëm për paditë e paraqitura pas hyrjes së tij në fuqi. Në fakt, në të gjitha rastet kur ligji procedural ka pësuar ndryshime apo shtesa, ligjvënësi është kujdesur të përcaktojë që rregullimet e reja kanë apo jo efekt prapaveprues.

Ndërkohë, në rastin konkret jemi para krijimit të një gjykate të re të sistemit gjyqësor, me një funksionim dhe organizim të ndryshëm, si dhe me rregulla të reja gjykimi të mosmarrëveshjeve administrative.

Në vlerësimin tonë, kompetenca lëndore është një çështje, përkatësia e së cilës lidhet me gjykatën e shkallës së parë dhe që duhet të zgjidhet që në momentin fillestar të gjykimit, pra që në gjykimin në shkallë të parë. Kompetenca lëndore nuk mund të ndryshojë me një ligj të ri, por vetëm nëse ligji përcakton në dispozitat e tij, në mënyrë të shprehur drejtpërdrejt dhe qartazi një zgjidhje të ndryshme lidhur me kompetencën lëndore, gjatë një gjykimi të filluar apo pasi ka përfunduar një shkallë e gjykimit.

Në këtë kuptim, mendojmë se nuk ka vend për diskutim përkatësia e kompetencës lëndore të gjykatës së shkallës së dytë, për të cilën diskutimi i vetëm mund të lidhet me kompetencën e saj funksionale për gjykimin e një çështjeje të caktuar, të ardhur përpara saj mbi ankimin kundër vendimit të një gjykate të shkallës së parë.

Nisur nga kjo, nëse kompetenca lëndore, në përputhje me ligjin e kohës, i ka takuar gjykatës së zakonshme, parimisht, nuk mundet që kjo kompetencë të ndryshojë kur çështja ndodhet në gjykim e sipër në gjykatat e të gjitha niveleve. Nëse ligjvënësi ngarkon një organ tjetër gjyqësor me kompetencën funksionale për gjykimin e ankimeve kundër vendimeve të gjykatave të zakonshme të shkallës së parë, atëherë këtë duhet ta bëjë me një urdhërim ligjor të shprehur, përndryshe do të ndodhemi para mungesës së kompetencës funksionale të organit tjetër gjyqësor.

Lidhur me gjykimin e çështjes konkrete për të cilën shumica shprehet se duhet të rigjykohej tashmë nga gjykata e apelit administrativ, në ligjin nr. 49/2012, në nenin 10, pika 2, germa "a", përcaktohet se: "*Gjykata Administrative e Apelit shqyrton: a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë; b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj*". Pra, në këtë dispozitë, ligjvënësi nuk ka ngarkuar gjykatën administrative të apelit për të shqyrtuar ankimet kundër vendimeve të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë, gjë të cilën nuk e ka bërë as me ndonjë dispozitë tranzitore të ligjit.

Për rrjedhojë, vlerësojmë se rregullimi i ri ligjor, i bërë me ligjin nr. 49/2012, në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatave administrative, nuk prek ato çështje, gjykimi i të cilave ka përfunduar në gjykatën e zakonshme të shkallës së parë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Po kështu, kemi të njëjtin mendim dhe për ato çështje, të cilat janë në gjykim e sipër në të gjitha shkallët e gjykimit, të cilat kanë nisur shqyrtimin e tyre para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Prandaj, pranimi i së kundërtës, qoftë dhe pranimi që gjykimi i ankimeve kundër vendimeve të dhëna nga gjykatat e zakonshme të shkallës së parë është në kompetencën funksionale të Gjykatës Administrative të Apelit, pikërisht për shkak të klasifikimit të mosmarrëveshjes si mosmarrëveshje administrative sipas rregullimit të ri ligjor, jo vetëm është në kapërcim të asaj që ligji ka përcaktuar, por indirekt, do të duhet të pranohej mungesa e kompetencës lëndore të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë, përveç se, në aplikim të rregullave të reja dhe konceptualisht të ndryshme procedurale para gjykatave më të larta në një proces gjyqësor, ku gjykimi në një shkallë të sistemit gjyqësor ka përfunduar tashmë.

Një gjë e tillë do të vinte në diskutim respektimin në çdo çështje konkrete të parimeve të procesit të rregullt ligjor, ashtu sikundër edhe kushtetutshmërinë e ligjit nr. 49/2012 në raport me çështjet gjyqësore, gjykimi i të cilave ka përfunduar në gjykatën e shkallës së parë dhe kundër vendimit të së cilës palët kanë ushtruar tashmë të drejtën e ankimit të njohur nga ligji procedural civil në fuqi në kohën e paraqitjes së tij.

Për këtë arsye kemi parasysh se ligji, si akt i përgjithshëm normativ, për më tepër në rastet kur vendos

rregulla të detyrueshme sjellje, si dhe në rastin konkret (ligji nr. 49/2012), aplikueshmëria e këtyre rregullave të reja sjellje lidhet me të ardhmen, por aspak me të kaluarën, pasi nuk mund të ribëhet ajo që tashmë ka ndodhur.

Thënë ndryshe, nëse do të pranohej se është Gjykata Administrative e Apelit ajo që duhet të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të dhëna nga gjykatat e zakonshme të shkallës së parë, atëherë do të duhet të pranohej se Gjykata Administrative e Apelit, në funksion të kontrollit gjyqësor të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, do të duhet të konsiderojë rregullimet e bëra nga ligji i ri (ligji nr. 49/2012), si për gjykimin në shkallën e parë, ashtu edhe për gjykimin në apel, përfshirë edhe rregullat për kufizimin e së drejtës së ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit (vendimet e paankimueshme, neni 45); për paraqitjen e provave të reja (neni 47); për kalimin asaj të ankimit (neni 47) apo për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi dhe gjykimin të saj mbi bazë dokumentesh (neni 49), rregulla këto që padyshim preknin të drejtat e personave konkretë (palëve në gjykim) të njohura nga ligji procedural civil në fuqi në momentin e ngritjes së padisë, shqyrtimit të çështjes nga gjykata e shkallës së parë dhe paraqitjes së ankimit kundër vendimit të saj, gjë që nuk mund të jetë qëllimi i një ligji.

Gjyqtarët e pakicës sjellin në vëmendje se në parim, në të drejtën procedurale, ligji i ri nuk ka efekt prapaveprues. Në vështrimin historik të ndryshimeve që ka pësuar K.Pr.Civile, në asnjë rast nuk ka pasur fuqi prapavepruese ky kod. Një fuqi të tillë nuk i është dhënë as në miratimin e tij fillestar në vitin 1996, por, përkundrazi, të gjitha çështjet e filluara më parë me procedurën e mëparshme u përfunduan mbi ato rregulla procedurale.

Rregullat procedurale, të përmendura më sipër, të cilat lidhen me procedurën e ankimit, me procedurën e gjykimin në gjykatën e apelit administrativ apo në Gjykatën e Lartë, janë të tilla të cilat përmbysin procedurën e gjykimin të nisur më parë. Çmujmë se nuk mund të ketë ndryshim të rregullave të “*lojës*” pasi ajo ka nisur, apo aq më tepër ka përfunduar një shkallë gjykim.

Ne gjyqtarët e pakicës shprehemi kundër, pasi vlerësojmë se ky vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë cenon edhe parimet e procesit të rregullt ligjor dhe, konkretisht, parimin e “*gjykatës së caktuar me ligj*”, “*gjykimin brenda një afati të arsyeshëm*” dhe atë të “*sigurisë juridike*”.

- Lidhur me cenimin e parimit të “gjykatës së caktuar me ligj”

Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se “1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik

brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”. Pra, një ndër parimet e procesit të rregullt është dhe parimi se gjykata duhet të jetë e caktuar me ligj. Kjo do të thotë se ajo kërkohet të jetë një gjykatë kompetente, të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit.

GJEDNJ-ja e ka përkufizuar një gjykatë si një organizëm që ushtron funksione gjyqësore, e krijuar me ligj për të përcaktuar çështjet brenda kompetencave të saj në përputhje me procedura të kryera në mënyrë të përcaktuar. Çdo gjykatë që shqyrton një çështje duhet të jetë e krijuar me ligj. Kushti që një gjykatë të krijohej me ligj zbatohet **jo vetëm për kuadrin institucional, por edhe për përbërjen specifike të saj në një çështje të caktuar.**

Gjykata Kushtetuese ka një praktikë të gjerë lidhur me parimin “*gjykata e caktuar me ligj*”. Kjo gjykatë ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Termi “*gjykatë*” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit^{3,4}.

Në rastin në gjykim, rezulton se gjyqtari është caktuar sipas ligjit që ka qenë në fuqi në kohën kur është paraqitur kërkesëpadia dhe konkretisht sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Me ligjin nr. 49/2012, u vendos krijimi i gjykatave administrative, të cilat funksionojnë si gjykata më vete (shkallë e parë dhe apel, si dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë), neni 4 i ligjit.

Me vendimin e Kolegjeve të Bashkuara është vendosur: “*Gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me ligjin nr. 49, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimin. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 4.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma*”. Ky konkluzion, i

³ Shih vendimin nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

⁴ Shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

arritur nga shumica duke interpretuar dispozitat tranzitore të ligjit nr. 49/2012, eliminon kompetencën lëndore për të gjykuar çështjet në gjykim e sipër të gjykatave të shkallës së parë, apelit dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pra, sjell përjashtimin e një trupi gjykues si jo kompetent sipas ligjit të ri nr. 49/2012, ndërkohë që ky trup gjykues ishte kompetent dhe caktuar konform legjislacionit procedural në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadisë.

Vlerësojmë se ky vendim bie ndesh me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6.2 të KEDNJ-së, pasi cenon parimin e “gjykatës së caktuar me ligj”.

Ne si pakicë vlerësojmë se në momentin që një trup gjykues është kompetent dhe është caktuar konform procedurave përkatëse ligjore për të gjykuar një çështje të caktuar, nuk mundet nëpërmjet dispozitave kalimtare të një ligji të mëvonshëm të largohet, duke u zëvendësuar me një trup tjetër gjykues të një gjykate të krijuar rishtazi (gjykata administrative).

Nëse kompetenca lëndore, në përputhje me ligjin e kohës, i ka takuar gjykatës së zakonshme, parimisht, nuk mundet që kjo kompetencë të ndryshojë kur çështja ndodhet në gjykim. Vazhdimi i gjykimit nga i njëjti trup gjykues përbën një garanci për respektimin e parimit në procesin e rregullt ligjor, atë të “gjykatës së caktuar me ligj”.

- Lidhur me cenimin e parimit të “gjykimit brenda një afati të arsyeshëm”

Pakica çmon, gjithashtu, se vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë cenon edhe të drejtën e çdo individi apo çdo subjekti tjetër të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së si një element tjetër i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Sipas interpretimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në çdo proces gjyqësor të filluar dhe që shqyrtimi nuk ka përfunduar akoma, çështja duhet të kalojë për gjykim në gjykatat administrative në të cilat gjykimi do të fillojë nga e para. Pra, çdo veprim procedural, çdo provë apo hetim i realizuar në këto gjykime, do të zerohen dhe çdo veprim procedural së bashku me gjykimin në tërësi do të nisë nga e para.

Ky konkluzion i vendosur nga shumica, çmojmë se sjell cenimin e procesit të rregullt ligjor lidhur me parimin e “gjykimit brenda një afati të arsyeshëm”, në të gjitha gjykimet e filluara para datës 4.11.2013, që urdhërohen të nisin nga e para nga gjykatat administrative, konkretisht:

- Lidhur me cenimin e parimit të “sigurisë juridike”

Vendimi i mësipërm i shumicës së Kolegjeve të Bashkuara ka sjellë edhe cenimin e parimit të **sigurisë juridike. Siguri juridike, e cila buron nga Kushtetuta dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës.**

Siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës dhe kjo siguri presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe

pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara.

Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, e drejta për një proces të rregullt ligjor garantuar nga neni 6§1 i Konventës duhet të interpretohet sipas preambulës së Konventës, e cila, në pjesën përkatëse, deklaroi që respektimi i ligjit duhet të jetë pjesë e trashëgimisë së përbashkët të shteteve kontraktuese ... gjykata shqyrtonte kërkesat që pretendojnë shkelje të garancive specifike procedurale ose pretendojnë që drejtimi i procedurës, si i tërë, nuk ka siguruar garancitë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të ankuarit⁵.

Pakica çmon të theksojë në këtë aspekt dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Kjo gjykatë, konceptin e sigurisë juridike e referon te parimi i shtetit të së drejtës, të së drejtës së fituar, të pritshmërisë së ligjshme dhe të besimit të qytetarëve të shteti, parim që është sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës dhe që duhet kuptuar e interpretuar në lidhje të ngushtë me aspiratën e shprehur në preambulën e Kushtetutës, ku është skalitur vendosmëria e popullit shqiptar “... për të ndërtuar shtetin e së drejtës, demokratik e social. “Shteti i së drejtës, i cili garantohet që në preambulën e Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përbën një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues”.⁶

Vendimi i shumicës, duke ndryshuar rregullat procedurale gjatë procesit në vazhdim e sipër, ka shkelur parimin e sigurisë juridike. Pakica ka parasysh dhe pasojat e vendimmarrjes në përgjithësi dhe në rastin konkret në veçanti.

Kolegjet e Bashkuara duhet të kishin marrë parasysh faktin se gjykimi rishtazi nga gjykatat administrative do të passjellë një ndryshim të rregullave procedurale sipas parashikimeve të ligjit të ri nr. 49/2012. Kjo sjell një tjetër gjendje psikologjike të palëve, të cilat cenohen në pritshmëritë e tyre të ligjshme dhe në besimin e tyre të shteti dhe drejtësia efektive.

Përfundimisht, si pakicë vlerësojmë se **gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes civile konkrete është Gjykata e Apelit Tiranë dhe jo Gjykata Administrative e Apelit, siç ka vendosur shumica e Kolegjeve të Bashkuara në këtë rast.**

Gjyqtarë: Edmond Islamaj, Shkëlzen Selimi, Admir Thanza

⁵ Shih vendimin e GJEDNJ-së, Mullai dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 23.3.2010, §79-80.

⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 34, datë 20.12.2005. Përmbledhje e vendimeve, viti 2005, f. 289.

URDHËR

Nr. 2027, datë 4.10.2013

**PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR SUBJEKTIN
“PAYLINK” SHA SI OPERATOR SKEME
KOMBËTARE TË PAGESAVE ME KARTË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 9, pika 3 të statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 100, datë 19.12.2000 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, nenit 2, paragrafi 1, nenit 6, paragrafët 1 dhe 2, nenit 14 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013 “Për sistemin e pagesave”, të neneve 7, 9, 10 dhe 14 të rregullores “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë”, miratuar me vendimin nr. 42, datë 26.6.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave,

URDHËROJ:

1. Miratimin e licencës për subjektin “Paylink” sh.a. për të vepruar si “Skemë kombëtare e pagesave me kartë” në Republikën e Shqipërisë, sipas formatit bashkëlidhur.

2. Veprimtaritë e lejueshme për operatorin “Paylink” sh.a. përshkruhen në aneksin bashkëlidhur licencës.

3. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave për komunikimin e këtij urdhri operatorit dhe me mbikëqyrjen e veprimtarisë së tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Europian dhe Komunikimit për publikimin e licencës në Fletoren Zyrtare, në Buletinin Zyrtar, si dhe në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR
Ardian Fullani

LICENCË
Nr. 1, datë 4.10.2013

**OPERATOR SKEME KOMBËTARE TË
PAGESAVE ME KARTË**

Në bazë të nenit 2, paragrafi 1, nenit 6 paragrafët 1 dhe 2 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013 “Për sistemin e pagesave”, të neneve 7, 9 dhe 10 të rregullores “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë”, miratuar me vendimin nr. 42, datë 26.6.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, “PAYLINK” sh.a. me seli qendrore në bulevardin “Zogu I”, pallati “Edicom”, kati i 13-të,

Tiranë, i jepet licenca për të vepruar si OPERATOR SKEME KOMBËTARE TË PAGESAVE ME KARTË në Republikën e Shqipërisë.

Licenca i lejon operatorit “PAYLINK” sh.a. të kryejë veprimtaritë e përshkruara në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme ose e tjetërsueshme.

**ANEKSI I LICENCËS
VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR OPERATORIN
“PAYLINK” SHA**

Veprimtaria e “Skemës kombëtare të pagesave me kartë” përfshin të gjitha aktivitetet e mëposhtme:

- a) administrimin e përgjithshëm të skemës;
- b) mbështetjen e emetimit të kartave, nëpërmjet prodhimit dhe personalizimit të tyre, procesimit të të dhënave, vërtetimit (*authentication*) dhe autorizim;
- c) mundësimin e përdorimit të kartave në ATM, terminale POS (POS/EFTPOS) terminale virtuale POS (virtual POS) etj.;
- d) administrimin e veprimeve në терминаlet e mësipërme për kryerjen e transaksioneve, duke përfshirë edhe prodhimin e të tilla pajisjeve;
- e) pranimin dhe shërbimet e komunikimit për kryerjen e transaksioneve; dhe
- f) klerimin e pagesave me kartë (përfshirë edhe infrastrukturën e nevojshme për shlyerjen e transaksioneve me kartë).

Operatori “Paylink” sh.a. mund të kryejë, nëpërmjet palëve të treta, vetëm aktivitetet e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “d”.

GUVERNATOR
Ardian Fullani

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 1420, datë 24.12.2013, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Armand Koxhaj, i biri i Agimit dhe i Virgjinushes, i datëlindjes 4.7.1970, Berat.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 20 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006